

"PIJACE/TREGU" d.o.o.

Broj 354/24

Tuzi, 24.01 2024 god.



## UDHËZUES

**PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACIONE NË POSEDIM TË**

**SHPK „TREGU“ TUZ**

Tuz, janar 2024

Në bazë të nenit 11 të Ligjit mbi qasje të lirë në informacione ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 44/12, 30/17) dhe nenit 40 të Statutit të SHPK "Tregu" Tuz, Drejtori Ekzekutiv i Shoqërisë me datën 24.01.2024, sjell

**UDHËZUESIN**  
**PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACIONE NË POSEDIM TË**  
**SHPK "TREGU" TUZ**

**1. TË DHËNAT THEMELORE MBI SHOQËRINË**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Pijace/Tregu" Tuzi është themeluar me Vendim të Kuvendit Komunal të Tuzit nr. 02-030/21-14528, datë 24.11.2021 ("Fleta zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale", nr. 40/21, datë 03.12.2021).

Emri i shkurtuar i Shoqërisë është "Pijace/Tregu" Tuzi.

Shoqëria është themelua si ndërmarrje njëanëtarëshe. Themelues i Shoqërisë është Kuvendi i Komunës së Tuzit.

Shoqëria është themeluar në periudhë të pacaktuar.

Selia e Shoqërisë është në Tuz, Tuz pn.

Informatat kontaktuese: tel: +382 68 092 020; email: [pijacetregutz@pijacetregu-tz.me](mailto:pijacetregutz@pijacetregu-tz.me).

**II LLOJET E INFORMACIONEVE NË POSEDIM TË SHOQËRISË**

Informacionet që i posedon SHPK "Tregu" Tuz janë:

- Regjistrat zyrtarë dhe të dhënat zyrtare (fragmente nga Regjistri qendror i subjekteve afariste mbi regjistrimin, regjistri i protokollit zyrtar, regjistri i punëtorëve, etj.)
- Vendim mbi themelimin e Shoqërisë
- Statuti i Shoqërisë
- Çmimorja e shërbimeve
- Programi vjetor i punës
- Rregulloret, aktet administrative
- Kontratat
- Aktet individuale (vendimet dhe aktvendimet)
- Procesverbalet dhe vendimet e organit drejtues

- Dokumentet financiare dhe dokumentet për prokurimin publik
- Akte të tjera të brendshme të Shoqërisë

### **III PROCEDURA PËR QASJE TË INFORMACIONIT**

#### **1. Nisja e procedurës**

Procedura inicohet me kërkesë me shkrim ose me gojë të personit që kërkon qasje në informacion.

Kërkesa me shkrim për qasje në informacion dorëzohet drejtpërdrejt, me postë ose nëpërmjet menyrës elektronike (e-mail). Kërkesa gojore për qasje në informacion paraqitet drejtpërdrejt në procesverbal.

Në kërkesë për qasje në informacion nuk paguhet taksa.

Kërkesa duhet të përmbajë:

- emrin e informacionit ose të dhënave në bazë të të cilave mund të identifikohet informacioni i kërkuar;
- mënyrën në të cilën duhet të realizohet qasja në informacion;
- të dhënat mbi parashtuesin e kërkesës.

#### **2. Mënyra e paraqitjes së kërkesës**

Kërkesa për qasje në informacion paraqitet:

- Direkt në arkivin e Shoqërisë;
- Nëpërmjet postës në adresën e Shoqërisë - Tuz, Tuz pn
- Në e-mail të Shoqërisë: [pijacetregutz@pijacetregu-tz.me](mailto:pijacetregutz@pijacetregu-tz.me).

#### **3. Mënyrat e realizimit të së drejtës në qasje të informacionit**

Qasja në informacion mund të arrihet:

- Me veshtrim të drejtpërdrejtë të informacionit në origjinal apo kopje së;
- Me rishkrim ose skanim të informacionit nga ana e parashtuesit të kërkesës në ambientet e Shoqërisë;
- Me dorëzim të kopjes së informacionit, parashtuesit të kërkesës, nga ana e Shoqërisë drejtpërdrejtë, përmes postes ose në mënyrë elektronike.

Qasja në informacionin në rastet e përmendura në pikat 1 dhe 2 realizohet në ambientet e Shoqërisë.

Shoqëria nuk është e detyruar të sigurojë qasje në informacion që është i disponueshëm publikisht dhe i publikuar në internet.

Në rastin nga paragrafi paraprak, Shoqëria do të informojë me shkrim parashtruesi, se informacioni i kërkuar është i publikuar (në Fletë zyrtare, internet, etj.).

#### **4. Zgjidhja sipas kërkesës dhe mbrojtja ligjore**

Kërkesa për qasje në informacion zgjidhet brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së duhur. Kundër vendimit të Shoqërisë, parashtruesi ose personi tjetër i interesuar mund të paraqesë ankesë në Agjencinë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasje të lirë në informacione, përmes kësaj Shoqërie.

Qasja në informacion arrihet brenda tri ditëve nga data e dorëzimit të vendimit për lejimin e qasjes, përkatësisht brenda pesë ditëve nga dita kur parashtruesi ka dorëzuar dëshminë për pagesën e shpenzimeve të procedurës, nëse ato janë përcaktuar me vendim.

Personi përgjegjës për zbatimin e procedurës për qasje në informacione është Marjan Lulgjuraj, spec i shkencave juridike, ndërsa në rast të mungesës së personit të caktuar, personi i autorizuar nga Drejtori Ekzekutiv i Shoqërisë.

#### **IV SHPENZIMET E PROCEDURËS**

Në kërkesë për qasje në informacion nuk paguhet taksa.

Mbartësi i shpenzimeve të procedurës është parashtruesi i kërkesës për qasje në informacion, në përputhje me Reegullorën mbi kompensimin e shpenzimeve në procedurën për qasjen e informacionit.

Shpenzimet shtesë mund të përcaktohen me vendim në përputhje me nenin 33a të Ligjit për qasje të lirë në informacion ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", numër 44/12, 30/17).

Shpenzimet e procedurës paguhen para ekzekutimit të vendimit.

Personat me aftësi të kufizuara dhe personat me nevoja sociale nuk paguajnë shpenzimet e procedurës.

Shpenzimet e procedurës paguhen në favor të sh.p.k. "Tregu" Tuz, në numrin e xhiro llogarisë: 520-44493-68. Nëse parashtruesi nuk paraqet dëshmi se ka paguar shpenzimet e procedurës, Shoqëria nuk do t'i sigurojë atij qasje në informacionin e kërkuar.

#### **V PUBLIKIMI I UDHËZUESIT**

Ky Udhëzues do të publikohet në tabelën e shpalljeve të Shoqërisë, si edhe në ueb faqen e Shoqërisë - <http://pijacetregu-tz.me>.

Udhëzuesi do të përditësohet në përputhje me nenin 11 paragrafi 3 i Ligjit mbi qasje të lirë në informacione ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", numër 44/12, 30/17), për çka është përgjegjës Shërbimi i Shoqërisë kompetent për çështje juridike.

Përpunuar nga: Marjan Lulgjuraj

*Marjan Lulgjuraj*

**DREJTORI EKZEKUTIV**

**Ruzhdi Ljuka**



*Ruzhdi Ljuka*

Na osnovu člana 9 Odluke o osnivanju Društva sa ograničenom odgovornošću „Pijace/Tregu“ Tuzi, a u skladu sa članom 28 Statuta Društva sa ograničenom odgovornošću „Pijace/Tregu“ Tuzi, **Odbor direktora** Društva na XXIV sjednici održanoj dana 29.01.2024. godine, donio je

### ODLUKU

1. Usvaja se Vodič za slobodan pristup informacijama u posjedu Društva sa ograničenom odgovornošću „Pijace/Tregu“ Tuzi, koji čini sastavni dio ove Odluke.
2. Odluka stupa na snagu danom donošenja.

### Obrazloženje

Članom 11 stav 1 Zakona o slobodnom pristupu informacijama („Službeni list Crne Gore“, broj 44/12, 30/17) je predviđeno da je organ vlasti dužan da sačini, objavi na svojoj internet stranici i da redovno ažurira vodič za slobodan pristup informacijama u svom posjedu.

U istom članu stav 3 propisuje se obaveza organa vlasti da vodič za pristup informacijama ažurira najmanje jednom godišnje, odnosno u roku od 30 dana od dana promjene vrsta informacija u njegovom posjedu i podataka od značaja za pristup informacijama.


Članom 9 Odluke o osnivanju Društva, kao i članom 28 Statuta je propisana nadležnost Odbora direktora Društva za donošenje akata.

**Prilog:** Vodič za slobodan pristup informacijama u posjedu DOO „Pijace/Tregu“ Tuzi br. 334/23 od 24.01.2024. godine

Broj: 335/24  
U Tuzima, 29.01.2024. godine

### ODBOR DIREKTORA DRUŠTVA PREDSJEDNIK

Fran Camaj, Spec. Sci. elektrotehnike



#### Dostavljeno:

- Arhiva Odbora direktora
- a/a